

URDHËRNr. 25, datë 04/12 /2023**PËR****MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR TË SHOQËRISË ALBGAS SH.A**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 848, datë 07.12.2016, për “Krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.A. dhe për caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.A. dhe Albgaz Sh.A”, i ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.108, datë 23.02.2018, të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar, Urdhrave nr.187 datë 18.12.2020, nr. 188 datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Statutit të Shoqërisë Albgaz sh.a si dhe rekomandimeve të bëra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në shkresën Nr.1883 Prot, datë 14.11.2023,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa plotësimeve në Programin e Transparencës së Shoqërisë Albgaz sh.a sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me Urdhrin nr.187 datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Plotësimet e përmendura në pikën 1, do t’i bashkëlidhen këtij urdhri dhe do të publikohen në faqen zyrtare të Albgaz sh.a, në rubrikën “Programi i Transparencës”
3. Ngarkohet Koordinatorin për të Drejtën e Informimit me zbatimin e këtij Urdhri dhe garantimin e zbatimit të dispozitavë të Ligjit për të Drejtën e Informimit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me pasqyrimin e tij në faqen zyrtare të Albgaz sh.a.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBER AVRAMI
ADMINISTRATOR

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ALBGAS Sh.a.